# ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES

Për Aktivitetin e Prokurimit: **701-23-3093-2-2-1 dhe 701-23-037-221**

Sa i përket tenderit për: **Servisimi dhe mirembajtja e sistemeve dhe instalimeve elektrike ne Kl . e Kirurgjisë Pediatrike.**

## ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

*OE: "Expert Company" Shpk*
*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

*Taulantia, nr.46*
*(Adresa)*

| | |
|---|---|
| *Prishtinë*<br>*(Vendi)* | 10000<br>*(Kodi postar)* |
| +383(0)44112418<br>*(Numri Telefonit)* | *N/A*<br>*(Numri i Faks-it)* |

*Bajram Cakiqi*
*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

expertks@gmail.com
*(Adresa elektronike)*

| | |
|---|---|
| *16.08.2023*<br>*(Data e parashtrimit të kërkesës)* | *(Nënshkrimi dhe vula)* |

SH.P.K. Expert Company

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

**2. Identifikimi i avokatit**

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim: N/A*

**3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit**

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

Autoriteti kontraktues – AK- QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES, me date 03.04.2023 ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull të kontratës: ": Servisimi dhe mirembajtja e sistemeve dhe instalimeve elektrike ne Kl . e Kirurgjisë Pediatrike", nr. prokurimi: 701-23-3093-2-2-1dhe nr. te brendshëm: 701-23-037-221, si në vijim:

- ☐ Procedure e hapur,
- ☐ Kontrate publike 12 muaj,
- ☐ Shërbim, Vlerë e MESME
- ☐ Vlera e parashikuar e kontratës 35,000.00 euro
- ☐ Kriteri për dhënie të kontratës: Çmimi me i ulte i tenderit të përgjegjshëm,

Afati i fundit për dorëzim te tenderëve, ka qen me date 24.04.2023 ora :12:00,
Vendi: Zyra e Prokurimit
Takimi për hapjen e tenderëve ka qen me datë 24.04.2023 ora :12:00 ne platformën elektronikë te prokurimit.

Me date 25.05.2023 është publikuar Vendimi i Autoritetit Kontraktues dhe letrat standarde për dhënie te kontratës dhe tenderuesit të suksesshëm dhe te eliminuar, ku jemi shpallur fitues të këtij aktiviteti.

Me datë 30.05.2023 është pezulluar aktiviteti për shkak të kërkesës për ri-shqyrtim.

Me datë 05.06.2023 AK ka aprovuar kërkesën për rishqyrtim të bazuar nga OE ankues dhe, pa e as një arsyetim, me datë 19.06.2023, AK ne kundërshtim me dispozitat e LPP-se anulon aktivitetin në tersi.

Bashkëngjitur ne këtë titull të këtij njoftimi kemi pranuar njoftimin për Letrën standarde B42 për tenderuesit e eliminuar dhe vendimin B58 të e AK-QKUK.

Me datë 23.06.2023 dhe brenda afatit ligjorë, kemi paraqitur kërkese për ri-shqyrtim ne pajtim me kërkesat e nenit 108/A, të LPP-se, kundër vendimit të AK për anulim të aktivitetit. (Bashkëlidhur me ketë ankese gjeni edhe kërkesën për ri-shqyrtim te dorëzuar në AK).

Me datë 10.08.2023, kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për Rishqyrtim si te pa bazuar (bashkëlidhur e gjeni vendimin e AK), përtej ç'do afati ligjorë ne kundërshtim me par 6 të nenit 108/A të LPP-se.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po [ ] Jo [x]

Hapja e tenderit është bere ne mënyre elektronike në vendin e caktuar dhe ne kohen e caktuar.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po [x] Jo [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po [x] Jo [ ]

Te pa kënaqur me rezultatin përfundimtar, lidhur me njoftimin për tenderuesin e eliminuar dhe vendimit të AK për rezultatit e aktivitetit të prokurimit, me datë 23.06.2023, brenda afatit ligjorë, kemi paraqitur kërkese për ri-shqyrtim ne pajtim me kërkesat e nenit 108/A, të LPP-se, kundër vendimit të AK për rezultatin e aktivitetit në fjalë.
(Bashkëlidhur me ketë ankese gjeni edhe kërkesën për ri-shqyrtim te dorëzuar në AK).

Me datë 10.08.2023, kemi pranuar refuzimin e kërkesës për Rishqyrtim si te pa bazuar (bashkëlidhur e gjeni vendimin e AK)

Dhe, te pa kënaqur me vendimin e AK për refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim si të pa bazuar, parashtrojmë ankese në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik ne pajtim me nenin 109 të LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Të pa kënaqur me Vendimin e AK- Autoriteti kontraktues – QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES dhe në pajtim me nenin 109 të LPP-së parashtrojmë ANKESË kundër;

- **Vendimin e AK për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim të dt. 10.08.2023;**
- **Njoftimit B42, Letër standarde për tenderuesin e eliminuar 19.06.2023 dhe**
- **Njoftimit B58, Njoftim mbi Vendimit te AK te datës 19.06.2023**

Pretendojmë se **QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES**, përmes Komisionit për vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e tenderit gjatë procedurës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderit ka bërë shkelje të dispozitave të;

**I. Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi LPP-së) dhe atë;**

- Neni 4.1.26, Palë interesi
- Nenit 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi par 1,2 dhe 6;
- Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave par 1, nen par 1.1 dhe 1.2;
- Neni 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve par 2 dhe 4
- Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit, par 1, nen par 1.1.
- Nenit 72 të LPP-së, të Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, par 1 dhe 2
- Neni 108/A, Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, par 6 dhe par 8, nen par 8.4.

**II. Dispozitat e Rregullores nr. 01/2022 të prokurimit publik (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi RRPP) dhe atë:**

- Neni 38, Sqarimi i Tenderëve, par 38.5
- Neni 40, par 40.1; 40.2; 40.6 nen par a;b dhe c
- Neni 43, Ndërprerja e procedurave të prokurimit, par 43.5 dhe 43.7
- Neni 97, Shkeljet e rënda, par 97.1 nen (k) dhe (o).

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

- ✓ **Pretendimi ynë ankimor ka të bëje me eliminimin e Ofertës tonë dhe anulimin e aktivitetit në tersi!**

Autoriteti Kontraktues, nuk e ka trajtuar siç duhet kërkesën për rishqyrtim, ne kundërshtim të plotë me dispozitat e nen par 8.4 të par 8 të nenit 108/A të LPP-se, ngase e refuzon kërkesën pa i shqyrtuar pretendimet tona dhe pa i arsyetuar ato, madje Vendimin për refuzim e nxjerr me mbi 40 ditë me vonesë në kundërshtim me par 6 të nenit 108/A të LPP-se, prandaj për ne është i pa pranueshëm vendimi i AK sepse jemi të përgjegjshëm dhe kemi ofruar çmimin me te ulët!

Ne vijim do ti trajtojmë pretendimet tona ne ANKESË duke e kundërshtuar :

- **Vendimin e AK për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim të dt. 10.08.2023;**

Vendimi i AK, për refuzim të kërkesës për rishqyrtim është nxjerrë në shkelje të nen par 1.1 dhe 1.2 të par 1 të nenit 56 të LPP-se dhe par 40.1; 40.2; 40.6 nen par a;b dhe c të nenit 40 të RrPP 01/2022, ngase edhe pse jemi të përgjegjshëm, na eliminon pa drejtësisht nga AK i prokurimit, madje vendimi për anulim të tërësishëm të aktivitetit është në kundërshtim të plotë nen par 1.1, te par 1, të nenit 62 të LPP-se dhe par 43.5 dhe 43.7, të nenit 43 të RrPP nr.01/2022, sepse anulon në tersi aktivitetin e Prokurimit ne shkelje të dispozitave të lartë cekura, madje vet vendimi i AK për refuzim është në kundërshtim me dispozitivin, ngase nuk ka arsyetim fare.

Sepse vendimi i AK në refuzim të kërkesës për rishqyrtim, përmban vetëm: **"Vendim - Refuzohet e pa bazuar kërkesa për Rishqyrtim".**

Pra vendimit të AK, nuk ka arsyetim fare, për me tepër akti administrativ i një vendimi është në kundërshtim me formën dhe përmbajtjen siç e përcaktojnë rregullat e përkatëse te Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 47 dhe 48, sepse AK ka nxjerre vendim i cili nuk ka arsyetuar fare e që është në kundërshtim me përmbajtjen e një akti administrativ.

Thënë tutje, vendimi i AK nuk është përmbajtjesor, nuk ka ofruar kundër argumente lidhur me pretendimet tona, por ne mënyre diskriminuese, tendencioze dhe ne kundërshtim me nenin 108/A par 8, nen par 8.4 refuzon kërkesën pa i shqyrtuar as një nga pretendimet tona, prandaj, me te drejte e kundërshtojmë vendimin e AK për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sepse është nxjerrë në shkelje të LPP-se dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe, në tërësinë e tije Vendimi është i pa drejte, tendencioz dhe diskriminues ndaj kompanisë tonë.

Pra, në rastin konkret, AK vepron në kundërshtim të plotë dispozitat e lartë cekura si dhe në shkelje të dispozitave të nen par (k) dhe (o), të par 97.1 të nenit 97 të rregullores 01/2022, për shkak të mos respektimit dhe shkeljeve të parimeve themelore të prokurimit publik të përcaktuar me LPP dhe ne trajtim jo të barabartë të ofertuesve gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit si dhe për shkak të sjelljeve jo profesionale dhe të gabuara të zyrtarit të prokurimit, për faktin se për veç që aplikon

kritere/kërkesa të cilat nuk kanë qene të parapara në NJK dhe DT gjatë eliminimit të kompanisë tonë vendimin për refuzim e nxjerrë me vonese me shume se 40 dite.

**Provë 1:** Njoftimi për Kontratë dhe Dosja e tenderit!

**Provë 2:** Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim me datë 10.08.2023

Prandaj, të gjitha konstatimet e lartcekura, njoftimin B42 për eliminim të ofertës tonë dhe vendimin të kërkesës për rishqyrtim, e bëjnë të pa qëndrueshëm, të pa drejtë, diskriminues dhe tendencioz dhe në shkelje të dispozitave ligjore, për shkak se, AK në vendim për refuzim, nuk ka mundur të arsyetoj as një nga pretendimet tona të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim, ngase jemi të përgjegjshëm sepse kemi ofruar dëshmi në përputhje me kriteret e përzgjedhjes dhe kemi ofruar çmimin me te ulët sipas kritereve të vlerësimit të përcaktuar ne DT dhe NJK.

Dhe, rrjedhimisht dhe mbi bazën e këtyre fakteve te lartë cekura, me të drejte e kundërshtojmë në tersi vendimin AK për refuzim të kërkese për ri-shqyrtim, sepse është nxjerrë ne shkelje të par 1,2 dhe 6 të nenit 7, par 1 të nenit 51, par 1.1 dhe 1.2 të nenit 56, par 2 dhe 4 të nenit 59, nen par 1.1 të par 1 të nenit 62 të LPP-se dhe par 43.5 dhe 43.7, të nenit 43 të RrPP nr.01/2022, ngase anulon pa drejtësisht në tersi aktivitetin e prokurimit në kundërshtim me dispozitat ligjore të cekura me lartë.

Kurse**, sa i përket njoftimit për eliminimin (Letrën standarde për tenderues te papërgjegjshëm-eleminuar) nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit dhe Njoftimit te Vendimit te AK për rezultatin e tenderit te datës 19.06.2023***,* qëndrojmë prapa kërkesës për rishqyrtim të dorëzuar në AK të cilën e kemi argumentuar dhe e cila është pjese e bashkangjitur në ketë ankesë.

Sa i përket pretendimit të parë se, kinse ne nuk kemi referenca të ngjashme është një e pavërtete, sepse ne kemi dorëzuar të gjithë dokumentacionin sipas kërkesave të AK në përputhje dhe relevante për aktivitetin në fjalë, por AK, pa drejtësisht na eliminon nga aktiviteti i prokurimit në kundërshtim me kriterin e përzgjedhjes të parapara nga AK në NJK dhe DT, ngase provat e dëshmojnë te kundërtën me atë që është munduar të arsyetohet AK në ne letrën standarde për eliminim.

**Provë: 3. Lista e Kontratave dhe Referencat EXPERT COMPANY.pdf!**

Sa i përket pretendimit të dytë për eliminimin e kompanisë tonë nga aktiviteti i prokurimit, kinse për shkak të stafit teknik, është po ashtu në kundërshtim me kriterin e përzgjedhjes të parapara nga AK në NJK dhe DT, ngase provat e dëshmojnë te kundërtën me atë që është munduar të arsyetohet AK ne letrën standarde për eliminim.

**Provë : 4. LISTA E STAFIT DHE DIPLOMAT.pdf**

Pra, bazuar në provat e lartë cekura të dëshmuara me rastin e dorëzimit të tenderit, AK, ka vepruar ne kundërshtim të plotë me dispozitat e par 4 të nenit 59 të LPP-së dhe në shkelje të par 40.1; 40.2; 40.6 nen par a;b dhe c, të nenit 40 të Rregullores 01_2022 të KRPP-së, për faktin se në si OE **“Expert Company” Shpk,** kemi plotësuar në tersi kriterin e përzgjedhjes të paraparë vet nga AK në NJK dhe DT, sepse AK ka kërkuar të ngjashme dhe, rrjedhimisht kontratat e punëve të përfunduara dhe referencat për ato kontrata lidhen ekskluzivisht me fushën relevante të aktivitetit të prokurimit të shpallur nga AK dhe lista e stafit është relevante me kërkesat e AK të parapara në NJK dhe DT.

Thëne tutje, AK është mjaft kundërthënës në dy pretendimet për eliminim, sepse ne rastin e parë të arsyetimit, eliminohemi për shkak të referencave të fushës së gjeneratorëve kinse referencat nuk janë të fushës se ngjashme, kurse ne pretendimin e dytë të arsyetimit, eliminohemi për shkak se stafi teknik nuk është i fushës Teknik i gjeneratorëve.

Pra, ne rastin konkret, AK brenda të njëjtit njoftim për eliminim ka dy arsyetime të ndryshme dhe, shtrohet pyetja pse janë kërkuar teknik të gjeneratorëve, kur referencat për shërbime, furnizime dhe punë me gjenerator, sipas tyre, nuk janë te ngjashme dhe si te tilla nuk janë pranuar nga AK?

Prandaj, nga provat e argumentuara të cilat janë dëshmi të pa kontestuara, njoftimi i AK për eliminim të Ofertës tonë nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit, **është pa qëndrueshëm, arbitrar, i qëllimshëm dhe në shkelej serioze të dispozitave ligjore të lartë cekura.**

Dhe rrjedhimisht, AK me ketë veprim bie ndesh me dispozitat e par. 1 , 2 dhe 6 të nenit 7 për shkak të trajtimit të pa barabartë dhe diskriminimit të kompanisë tonë dhe në shkelje të parimeve themelore të LPP-së.

Madje, AK në kundërshtim me dispozitat e par 2 të nenit 59 dhe par 1 të nenit 72 të LPP-se dhe par 38.1 të nenit 38 të RRPP, nuk kërkon informata sqaruese qoftë nga OE apo edhe nga institucionet përkatëse të lëshimit të diplomave/certifikatave, ngase nuk ka drejtim të vetëm për Teknik të Gjeratoreve, por, për fushën përkatëse certifikatat nga institucionet vendore lëshohen nen emërtimin **dega Makineri**, drejtimi **Automekanik**, e që në rastin konkret është në përputhje të plotë me specifikat teknike të AK dhe është relevante me aktivitetin e prokurimit në fjalë.

Prandaj, çdo tentim i AK për të arsyetuar eliminim e Ofertës tonë nga aktiviteti i prokurimit dhe për të anuluar në tersi aktivitetin e prokurimit është i pa pranueshëm i pa drejtë, i pa qëndrueshëm, arbitrar, i qëllimshëm dhe në shkelej serioze të kritereve të përzgjedhjes dhe në shkelje të dispozitave të nenit 62, të LPP-se, sepse dispozitat ligjore përcaktojnë se ne cilat raste dhe ne cilat situata duhet te anulohet një tender.

Ne vijim **citojmë dispozitat e LPP-se, nenit 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit**:

1. *Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:*
   *1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.*

2. *Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:*
   *2.1. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo*
   *2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë*

*kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.*

Madje, edhe RrPP, Ndërprerja e procedurave të prokurimit, par 43.5 dhe 43.7 nuk e parasheh një situate të tillë të anulimit.

Nëse referohemi ne dispozitat ligjore të LPP-se, as një nga dispozitat e këtij ligji nuk e parashohin një situate te tille te anulimit te aktivitetit të prokurimit, për faktin se provat e dëshmuara me rastin e dorëzimit të tenderit e vërtetojnë katërçipërisht se jemi në përputhje të plote me kërkesat e AK.

Për me tepër vet AK na fazën e parë të vlerësimit **na ka shpërblyer me kontratë**, për faktin se kemi **qene të përgjegjshëm.**

**Provë 5:** Njoftimi fillestar-Vendimi B58, i datë 25.05.2023!

Prandaj, bazuar ne dispozitat ligjore të parapara në LPP dhe RrPP, AK nuk mund të anuloj aktivitetin e prokurimit kur ka OE të përgjegjshëm dhe brenda buxhetit të AK, sepse kjo çështje është e rregulluar me LPP-ne dhe RrPP.

Dhe, rrjedhimisht, duke pasur parasysh se, jemi palë me interes juridiko material ne kuptim të nenit 4.1.26 të LPP-se, sepse jemi të përgjegjshëm dhe kemi ofruar çmimin me te ulët, kërkojmë nga **OSHP-ja**, të nxjerr:

## VENDIM

- ✓ Të nxjerrë vendim meritor me të cilin të aprovoj ANKESEN të bazuar të paraqitur nga **"Expert Company" Shpk** Prishtinë.
- ✓ Te anuloj vendimin e AK – QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES, për refuzim të kërkesës për Ri-shqyrtim, sepse **Expert Company" Shpk** Prishtinë, ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;
- ✓ Te kthej rastin ne Ri-Vlerësim dhe vlerësimi të behet me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë duke shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik të përgjegjshëm që ka dorëzuar çmimin më të ulët.

Mbetemi me shpresë se Ankesa jonë do të shqyrtohet pozitivisht.
Me respekt,

Bajram Cakiqi

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Shpenzimet administrative;
Fitimin e humbur.

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*
h) **Provë** *1: Njoftimi për Kontratë dhe Dosja e tenderit;*
i) **Provë** *2: Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim me datë 10.08.2023*
j) ***Provë:*** *3 Lista e Kontratave dhe Referencat EXPERT COMPANY.pdf;*
k) ***Provë:*** *4 LISTA E STAFIT DHE DIPLOMAT.pdf*
l) **Provë** *:5 Njoftimi fillestar-Vendimi B58, i datë 25.05.2023*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

**eXpert company** SH.P.K
P R I SH T I N Ë
N. UNIK ; **811365883**
N.LOG; **1701017600158424** NLB

Tel : 044 112 418
038 540 911
E-mail: expertks@gmail.com

## LISTA E KONTRATAVE , DHE REFERENCAT
## (Pergjat tri viteve te fundit)

| Nr | Autoriteti Kontraktues | Vendi | Titulli | Numri I kontratesë | Data e fillimit dhe mbarimit | Vlera e kontratesë |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Qendra Kryesore Mjekësis Familjare | Prishtinë | Mirmbajtja e gjeneratorve ne QKMF dhe njisit e saj | 73350/19/9331/236 | 30.12.2019/29.12.2020 | 8461.00 |
| 2 | Qendra Klinike Univerzitare | Prishtinë | Servisimi I Gjeneratorve ne Hapsirat e QKUK | 701/20/4081/236 | 10.12.2019/05.01.2020 | 5621.00 |
| 3 | KQZ | Prishtinë | Servisimi I Dy Gjeneratorve në QNR | 320/21/035/247 | 01.02.2021 | 941.00 |
| 4 | KQZ | Prishtinë | Servisimi I Dy Gjeneratorve në QNR | 320/21/078/247 | 28.09.2021 | 482.50 |
| 5 | Qendra Kryesore Mjekësis Familjare | Prishtinë | Mirmbajtja e gjeneratorve ne QKMF dhe njisit e saj | 73350/20/8599/236 | 01.02.2021/31.012022 | 8423.00 |
| 6 | Qendra Klinike Univerzitare | Prishtinë | Furnizimi me modul per ndezje automatike të Gjeneratorit në Kliniken e Ortopedisë | 701 21 022 147 | 16.02.2021 | 495.00 |
| 7 | NPL Pallat I Rinisë SHA | Prishtinë | Servisimi dhe mirembajtja e gjeneratoreve | PR 2019-21-356-2-3-6 | 09.03.2021/08.03.2022 | 2000.00 |
| 8 | KPMM | Prishtinë | Servisimi dhe mirmbajtja e Gjeneratorit | 318-20-018-2-4-7 | 28.07.2020/27.07.2021 | 839.00 |
| 9 | KPMM | Prishtinë | Servisimi dhe mirmbajtja e Gjeneratorit | 318-21-012-2-4-7 | 18.06.2021/08.06.2022 | 993.98 |
| | | | | | Gjithsej | 28256.48 |

**Expert Company SHPK**
**Prishtinë**

SH. P. K. Expert Company Prishtinë

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

Rr. "Fehmi Agani" nr.22 – Prishtinë

PRISHTINË

| | |
|---|---|
| Datë: | 29.12.2020 |
| Për: | SH.P.K"EXPERT COMPANY"- Prishtinë |
| Nga: | Zyra e Prokurimit në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare - Prishtinë |
| Tema: | REFERENCË |

Me këtë leterë – referencë, konfirmojmë se kompania SH.P.K"EXPERT COMPANY"- Prishtinë, me numer biznesi 811365883 me përfaqsues Z.Bajram Cakiqi,në cilsin e operatorit ekonomik ka realizur Kontraten:

Titulli:" Mirëmbajtja e gjeneratorve në QKMF dhe njësit e saj"

Nr. Prokurimi:73350-19-9331-2-3-6 dhe

Numri i mbrendshëm i prokurimit:QKMF-19-023-2-3-6

Realizimi i kontrates arrin vleren në total prej gjithësejt: 8461.00 €

Me këtë dëshirojm të konfirmojm se kontraktori ka berë realizimin konform kritereve dhe kërkesave të parashtruara nga Autoriteti Kontraktues dmth ka përmbush me përputhmëri dhe korrektësi të gjitha kushtet e Kontrates si në aspektin teknik cilësor dhe dinamik, me ç'rast e falenderojmë prandaj shprehim kënaqësin tonë që bashkpunimi të vazhdoj edhe në të ardhmen,prandaj e rekomandojm tek Autoritetet tjera Kontraktuese.

Kjo referencë lëshohet me kërkesë të pales"SH.P.K"Expert Company"

Për çdo informatë rreth kësaj reference mos hezitoni të na kontaktoni:

Tel:+383 (0)38 224 589

Selvete Peci

Zyrtare Përgjegjëse e Prokurimit-QKMF

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada-Government***
**Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës**

**Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-Hospital and University Clinical Service of Kosovo**

***Qendra Klinike Universitare e Kosovës***
***University Clinical Centre of Kosova-Klinički Univerzitetski Centar Kosova***

| | |
|---|---|
| Datë | 14.12.2020 |
| Për: | EXPERT COMPANY SHPK - PRISHTINË |
| Nga: | Zyra Prokurimit në Qendra Klinike Universitare e Kosovës |
| Tema: | REFERENCË |

Me këtë leterë-Referencë, konfirmoim se kompanija NSHT EXPERT – Prishtinë, ka qen kontraktuesi i ynë për sherbime, ne rastin e shpalljes së procedures për;

Titulli i kontratës: **Servisimi i gjeneratorve në hapsirat e QKUK-sëdhe me nr te prokurimit;Nr. i Prokurimit ; 701-20-4081-2-3-6**

**Vlera e kontratës: 5621.00€**

Me këtë deshirojm të konfirmojmë se sherbimet e marrura nga kompanija: EXPERT COMPANY SHPK – Prishtinë, kan qen të cilsisë së lart konform kritereve dhe në përputhëshmeri të plotë me kerkesat e parashtruara nga Autoriteti Kontraktues.

Po ashtu kompanija në fjal ka treguar profesionalizum të lart dhe bashkëpunim, duke ofruar zgjidhje në krkesat tona shtesë të cilat janë shfaqur gjat realizimit të sherbimeve, me ç'rast e falenderojm. Kompanija e lartëcekur ka përmbush me përputhëshmeri dhe korrektsi të gjitha kushtet e kontrates si në aspektin profesional, teknik, cilsor dhe dinamik, prandja e rekomandojmë tek Autoritetet tjera Kontraktuese.

Zyra e Prokurimit; QKUK-Prishtinë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Komisioni Qendror i Zgjedhjeve***
***Centralna Izborna Komisija***
***Central Election Commission***

Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

**REFERENCË**

Operatori Ekonomik,, SHPK EXPERT COMPANI " Prishtine I ka kryer shërbime - sipas kontratës Servisim i dy gjeneratorëve ne QNR për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës me nr. te prokurimit 320/21/035/247 dhe me nr biznesit 8111365883 cilën e përfaqëson, Bajram Cakiqi .

Kjo kompani ka kryer te gjitha obligimet e parapare me kontratë, te kontraktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ne Prishtinë te datës 01.02.2021. Vlera ekzekutive e kontratës është 941.00 €

Me këtë referencë konfirmojmë shërbime te mira dhe cilësore .

Respektimi i kohës dhe kujdesi i lartë për shërbime është karakteristik e veçante e kësaj kompanie.

Nexhmi Haxhiu

Drejtor i Njësisë se Prokurimit

***Prishtinë:***

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Komisioni Qendror i Zgjedhjeve***
***Centralna Izborna Komisija***
***Central Election Commission***
Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

**REFERENCË**

Operatori Ekonomik,, SHPK EXPERT COMPANI " Prishtine I ka kryer shërbime - sipas kontratës Servisim i dy gjeneratorëve ne QNR me nr. te prokurimit te brendshem 320/21/078/247 dhe me nr biznesit 8111365883 cilën e përfaqëson, Bajram Cakiqi . Kjo kompani ka kryer te gjitha obligimet e parapare me kontratë, te kontraktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ne Prishtinë te datës 28.09.2021. Vlera ekzekutive e kontratës është 482.50 €

Me këtë referencë konfirmojmë shërbime te mira dhe cilësore .
Respektimi i kohës dhe kujdesi i lartë për shërbime është karakteristik e veçante e kësaj kompanie.

Nexhmi Haxhiu

Drejtor i Njësisë se Prokurimit
***Prishtinë:***

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE-PRISHTINË
E PRANUAR NË ARKIV
Nr. 627 Dita, muaji e viti 17 MAR 2022

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

Rr. "Fehmi Agani" nr.22 – Prishtinë

PRISHTINË

| | |
|---|---|
| Datë: | 17.03.2022 |
| Për: | SH.P.K"EXPERT COMPANY"- Prishtinë |
| Nga: | Zyra e Prokurimit në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare - Prishtinë |
| Tema: | REFERENCË |

Me këtë leterë – referencë, konfirmojmë se kompania **SH.P.K"EXPERT COMPANY"**- Prishtinë, me numer biznesi 811365883 me përfaqsues Z.Bajram Cakiqi,në cilsin e operatorit ekonomik ka realizur Kontraten:

**Titulli:" Mirëmbajtja e gjeneratorve në QKMF dhe njësit e saj"**

**Nr. Prokurimi:73350-20-8599-2-3-6 dhe Numri i mbrendshëm i prokurimit:QKMF-20-045-2-3-6**

**Vlera e Kontrates: 8,423.00 €**

Me këtë dëshirojm të konfirmojm se pala kontraktuese "EXPERT COMPANY" ka berë realizimin kontrates konform kritereve dhe kërkesave të parashtruara nga Autoriteti Kontraktues ka përmbush me përputhmëri dhe korrektësi të gjitha kushtet e kontrates,ka tregu korrektësi në dhënjen e sherbimeve,përgjegjësi maksimale si në aspektin teknik cilësor dhe dinamik, me ç'rast e falenderojmë prandaj shprehim kënaqësin tonë që bashkpunimi të vazhdoj edhe në të ardhmen.

Kjo referencë lëshohet me kërkesë të pales"SH.P.K"Expert Company"me qëllim të prezentimit me rastin e ofertimit në tenderët e kësaj natyre.

Për çdo informatë rreth kësaj reference mos hezitoni të na kontaktoni:

Tel:+383 (0)38 224 589

Referenca i dergohet:

Palës
Arhives(kopje)

Selvete Peci

Zyrtare Përgjegjëse e Prokurimit-QKMF

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
SHËRBIMI SPITALOR DHE KLINIK UNIVERSITAR I KOSOVËS - UNIVERSITETSKE BOLNIČKE I KLINIČKE SLUZBE KOSOVA - THE HOSPITAL AND UNIVERZITY CLINICAL SERVISE OF KOSOVO
ARKIVI QËNDROR - CENTRALNI ARHIV - CENRAL ARCHIVE
Nr.i njësis org / org.jed / org.unit: /
Nr.Prot. / Broj. prot. / Prot. no.: 198/2
Nr. i faq. / Br. str. / No. page: -1-
Data / Datum / Date: 16-02-21
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Qeveria –Vlada-Government**

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës-( SHSKUK)
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-(UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo-(HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës- Universitetski Klinikcki Centar Kosova – University Clinical Center of Kosovo

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| REFERENCË: | | | | | |
| PËR/ZA/TO: | Zyra e Prokurimit | | | | |
